



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1131 Prot.

Tiranë, më datë 12.09.2023

**VENDIM**  
**Nr. 482, datë 12.09.2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.09.2023:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e konceptit për kryerjen e Sondazheve Arkeologjike në kuadër të projektit “Kompleks turistik me shtëpi pushimi, shërbime dhe hotel 5\*, Zvërnec, Vlorë, Shqipëri”, Brenda Zonës së Mbrojtur të Qytetit antik Triport, Monument Kulture i kategorisë I, me aplikues MB Studio dhe zhvillues **Green Investment sh.p.k**;
2. Krahas 4 sondazheve arkeologjike të propozuara nga subjekti i licencuar Z. Ylli Cerova, të realizohet edhe një sondazh tjetër në afërsi të murit antik të Triportit me përmasa 7x2m, sipas koordinatave të përcaktuara nga IKTK;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Kompleks turistik me shtëpi pushimi, shërbime dhe hotel 5\*, Zvërnec, Vlorë, Shqipëri”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë projekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
4. Rezultati i sondazheve arkeologjike duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

KRYETAR

Elva MARGARITI

